



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr. 84/2020

**PËR PRANIMIN E VENDIMIT II/1 TË PALËVE, QË NDRYSHON
“KONVENTËN E AARHUSIT PËR TË DREJTËN E PUBLIKUT PËR TË PASUR
INFORMACION, PËR TË MARRË PJESË NË VENDIMMARRJE DHE PËR T’IU
DREJTUAR GJYKATËS PËR ÇËSHTJET E MJEDISIT”, RATIFIKUAR ME
LIGJIN NR.8672, DATË 26.10.2000**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Pranohet vendimi II/1 i palëve, që ndryshon “Konventën e Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”, ratifikuar me ligjin nr.8672, datë 26.10.2000, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 2.7.2020